



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:324008

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06579784

2024:337364

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ–DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me Kryetaren e trupit gjykues Fitore Daci si dhe zyrtaren ligjore Egzona Livoreka, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.D, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1, të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/I.Nr.126/24, të datës 26.11.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në praninë e Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku, të akuzuarit B.D dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av.Shpëtim Vishi, me datë 10.12.2024, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 11.12.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.D, i lindur me datë, në Kaçanik, nga babai S..... dhe nëna A..... e gjinisë B....., me vendbanim rrugën “.....”, nr....., Kaçanik, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal, ka qëndruar në paraburgim nga data 13.11.2024, deri me datë 10.12.2024.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë, rreth orës, në shtëpinë e tij në rrugën ”.....”, numër, në Kaçanik, ka poseduar pa autorizim dhe me qëllim shitje dhe shpërndarje substancë narkotike të llojit marihuanë dhe një sasi kokainë, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga njësia e policisë të DHTN-së në Ferizaj , në dhomën e tij janë gjetur një qese najloni me substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë neto 240.80 gram, tri qese najloni me substancë narkotike të llojit kokainë me peshë neto 1.3 gram, një qese najloni me substancë narkotike zë llojit marihuanë me peshë neto 0.39 gram, substancë narkotike e llojit marihuanë me peshë neto 0.82 gram, qese najloni të zbrazëta për paketim të substancave narkotike , dy peshore digjitale ngjyrë hiri dhe një peshore digjitale ngjyrë e zezë, të cilat janë konfiskuar nga ana e policisë.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 paragrafi 1, të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, dhe nenit 267 paragrafi 1, të KPRK-së, dhe neneve 230 dhe 364, të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Në dënimin e shqiptuar do të i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga data 13.11.2024, deri me datë 10.12.2024.

Si dhe dënim me gjobë në shumë prej 5.000 € (pesë mijë euro), te cilën gjobë është i obliguar të e paguajë në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 43 paragrafi 3, të KPRK-së, dënimi i caktuar me gjobë do të i shndërrohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro, të akuzuarit do të i llogaritet një ditë burgim.

Konform nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së, konfiskohen në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë në peshë prej 242.01 gram, si dhe substanca narkotike e llojit kokainë në peshë prej 1.3 gram, tri peshore digjitale dhe qeset e najlonit për paketim të substancës narkotike.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe të paguajë shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur Aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën e evidentuar si PP.I.nr.126/24, të datës 26.11.2024, ka akuzuar B.D, për shkak të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1, të KPRK-së.

Kryetarja e trupit gjykues pasi që ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë me datë 10.12.2024 në të cilën seancë i akuzuari, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan përkritazi me marrëveshjen për pranimin të fajësisë dhe i kanë propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara.

Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoi se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 230 paragrafi 17, të KPPK-ës:

- I akuzuarit B.D ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij Av.Shpëtim Vishi.

Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në provat materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë:

- Raporti i oficerit i datës
- Procesverbali për kontroll dhe sekuestrim të përkohshëm i datës
- Vërtetimi për konfiskimin e sendeve e datës
- Raporti i testit fushor i datës , fotografit për provat e sekuestruara;
- si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 248 paragrafi 1, të KPPK-së.

Andaj, gjykata pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këto marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi ligjor

Vlerësuar në aspektin juridik Gjkata gjeti se në veprimet e të akuzuarit B.D, ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 par 1 të KPRK-së, pasi që tek i akuzuari me datë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë gjetur peshat e substancave narkotike, peshoret digjitale si dhe qeset e najlonit të cilat i akuzuari i ka poseduar pa autorizim dhe me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes.

Vlerësimi për dënimin e shqiptuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjkata vlerësoj se i akuzuari ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe përmes dënimit të shqiptuar në këtë marrëveshje është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes se veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprave penale, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e këtyre veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Paraburgimi

Të pandehurit pas shpalljes së këtij aktgjykimi, konform nenit 366 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të KPPK-së, i është ndërprerë masa e paraburgimit, pasi që kanë pushuar kushtet për të cilat i është caktuar kjo masë.

Konfiskimi dhe shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi konfiskim është marrë konform nenit 267 paragrafi 5, të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6, të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 paragrafi 3, pika 3.2, Nr. 08/L-109, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
2024:337364, datë 11.12.2024**

**Zyrtare ligjore
Egzona Livoreka**

**Kryetarja e trupit gjykues
Fitore Daci**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.